

VENDIM
Nr.582, datë 27.7.2011

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR
IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË
TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”, si dhe të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për hartimin dhe harmonizimin e udhëzimeve përkatëse, në zbatim të këtij vendimi, duke bashkëpunuar me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe me organizata të shoqërisë civile, me eksperiencë dhe me kontribut në luftën kundër trafikimit të personave.

3. Institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtij vendimi të planifikojnë kostot financiare për zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha